



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

**K.Dh.Sh.II.nr.102/2023**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në çështjen juridike të kreditores T.C. nga Prizreni të cilën me autorizim e përfaqëson N.K. avokat ne Prizren, kundër debitorit C.C. nga Prizreni, duke vendosur sipas detyrës zyrtare për kompetencën lëndore, në bazë të shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari i vetëm, me datë 19.05.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë shpallen **JOKOMPETENTE lëndore**, për të vendosur në këtë çështje juridike.
- II. Shkresat e kësaj lënde do t’i dërgohen Gjykatës së Apelit të Kosovës, si gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje kontestimore.

**A r s y e t i m**

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, nga Gjykata e Apelit kanë pranuar lëndën e cila është regjistruar me numrin Kom.Dh.Sh.II nr.102/2023 në çështjen permbarimore në mes T.C. nga Prizreni dhe C.C. nga Prizreni, me objekt permbarimin e dokumentit permbarimo.

Dhomat e Shkallës së Dytë, pas shqyrtimit të lëndës dhe objektit të shqyrtimit që ka të bëjë me çështje permbarimore, ku kërkohet permbarim i dokumentit permbarimor – aktgjykimit CP.nr.148/2022 i datës 17.05.2022 i Gjykatës Themelore ne Prizren, për zgjidhjen e martesës ne mes te ndërgjyqësve.

Kjo gjykate, duke vlerësuar kompetencën e saj lëndore sipas dispozitave të Nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, konsideron se Gjykata e Apelit gabimisht e ka dërguar këtë lëndë për vendosje në Gjykatën Komerciale. Në këtë drejtim Kolegji gjen se për të vendosur lidhur me ankesën ndaj aktvendimit, si gjykatë e shkallës së dytë në pikëpamje lëndore është pikërisht Gjykata e Apelit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, bazuar në dispozitat e Nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo Gjykatë ka kompetencë për të gjykuar si parim, vetëm (par.1 pika 1.1) “*kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre*”. Po ashtu, sipas Nenit 13 par.1 pika 1.7 të Ligjit kjo Gjykatë ka nën jurisdiksionin ekskluziv edhe zgjidhjen e “*kontesteve në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e*

*paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare”.*

Për të referuar çështjet në kompetencën lëndore të kësaj Gjykate, vlerësojmë se gjykatat duhet të kenë si pikënisje qëllimin e themelimit të Gjykatës Komerciale dhe rrjedhimisht fushëveprimin e saj. Në këtë drejtim me Nenin 2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale përcaktohet se *“Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, vendorë dhe të huaj përfshirë shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës të cilët kanë konteste tregtare ndërmjet tyre”*. Së këndejmi, konsiderojmë se kjo Gjykatë në fushëveprimin e saj primar ka tagër për të vendosur vetëm për kontestet që në plan të parë kanë karakter tregtar, apo çështje të ndërsjella të paraparë me Nenin 13 të Ligjit që rrjedhin nga afarizmi i tyre.

Andaj, çështja konkrete si me larte rezulton se nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Komerciale dhe konsiderojmë se Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur sipas mjeteve juridike.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 17, 19 dhe 392 pika (b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.shk.II.nr.102/23, me datë 19.05.2023**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**